



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV. REKTOR PER KERKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL

Nr. 1171/1 Prot

Vlorë, më 02/ 11 /2018

Lënda: Përcillet raporti dhe projekt propozimet për rritjen e cilësisë së programeve të studimit, bazuar në rezultatet e pyetësorit studentor mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi për vitin akademik 2017-2018

Prof. Dr. Roland ZISI
REKTOR

I nderuar zoti Rektor,

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 103 mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, Vendimit të Senatit Nr.21, datë 08.05.2018 "Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë, si dhe shkresës me nr 1171 prot, datë 08.10.2018 të Drejtorit të DSBCZHI "Analiza e rezultateve të pyetësorit studentor mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi për vitin akademik 2017-2018", në përfundim të shyrimit prej meje të gjithë analizës, ju përcjellim bashkëlidhur për miratim raportin dhe projekt- propozimet për rritjen e cilësisë së programeve të studimit.

ZV. REKTOR

PhD Sokol BANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL

**ANALIZA E REZULTATEVE TË PYETËSORIT STUDENTOR MBI CILËSINË
E MËSIMDHËNIES PËR LËNDËT E ÇDO PROGRAMI STUDIMI PËR VITIN
AKADEMIK 2017-2018**

Përgatiti raportin:

Rezarta Sinanaliaj - **Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe
Zhvillimit Institucional**

Irena Toshkallari - **Përgjegjës i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe
Vlerësimit Institucional**

Daren Koleka - **Specialist i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe
Vlerësimit Institucio**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL

HYRJE

Ky raport vjen në kuadër të politikave të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe europian për Arsimin e Lartë. Studentët duke qenë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, vlerësimet e tyre mbi programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike dhe administrative që ofron universiteti.

Objekt i vlerësimit janë të gjitha lëndët mësimore të realizuara gjatë vitit akademik 2017-2018 në UV. Ky raport ka për qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira.

Raporti është i organizuar në katër pjesë kryesore (shtojca), të cilat përkojnë me njësitë kryesore të Universitetit. Për çdo njësi kryesore paraqitet përqindja e pjesëmarrjes mesatare të studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe programit të studimit të ndara sipas programeve të studimit, rezultatet e pyetësorëve si dhe rekomandimet dhe sugjerimet përkatëse.

Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.

Baza Ligjore:

Ky raport u realizua në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të NJSBC të cilat rrjedhin prej përcaktimeve ligjore dhe urdhërave të brendshëm të Institucionit. Më specifikisht:

- Në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 103 mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, përcaktohet se:
 - "Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimit- shkencor"
 - "Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi".
- Urdhëri i Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë Nr. 21 datë 22.02.2018 për "*Organizimin e pyetësorit Studentor për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi*".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL

- Detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej pozicionit të përcaktuara në shkresën Nr. 205/1 prot datë 14.02.2018 mbi mbi "Përshkrimin dhe detyrat e vendit të punës të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personelit administrativ në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Njësia e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional:
 - Verifikon, matë dhe vlerëson, krahasuar me standartet e kërkuara realizimin e objektivave kryesorë të programeve të studimit dhe cilësinë e programeve të ofruara.
 - Realizon të gjitha detyrat që lidhen me vet-vlerësimin e programve akademike në veçanti që kryehet çdo vit.

Metodologjia:

Metodologjia e studimit është sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësori i miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 52 datë 20.04.2017 (bashkëlidhur gjendet formati). Pyetësori është i përbërë prej 14 pyetjeve të mbyllura dhe 2 pyetjeve të hapura. Pyetjet e mbyllura janë përpunuar statistikisht në sistem me programin UVMS.

Opinionet e studentëve mbi pyetjet e hapura gjenden të hollësishme në secilën prej vlerësime bashkëlidhur, për çdo pedagog që ka dhënë mësim në ciklin e parë të studimeve

Pjesëmarrës në studim janë të gjithë studentët e Ciklit të Parë të Studimeve pranë Universitetit "Ismail Qemali", që kanë një llogari personale në sistemin elektronik të Universitetit dhe që kanë frekuentuar qoftë dhe një lëndë të vetme përgjatë vitit akademik 2017-2018. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin gjatë semestrit të parë u vendos si parakusht për marrjen e rezultatit të provimit në lëndën përkatëse plotësimi i formularit online, ndërkohë që gjatë semestrit të dytë studentëve ky parakusht iu hoq, duke ndikuar drejtëpërdrejtë në uljen e numrit të studentëve pjesëmarrës në pyetësor.

Duke qenë se në politikat e Universitetit cdo mendim i studentit, qoftë edhe në minorancë është i rëndësishëm, të dhënat e semestrit të dytë janë përlllogaritur në mesataren aritmetike sëbashku me të dhënat e semestrit të parë, edhe pse këto të dhëna nuk janë domethënëse dhe përfaqësuese për programin dhe lëndën përkatëse. Vlen për tu theksuar që numri i formularëve të plotësuar më sipër nuk përfaqëson numrin e studentëve pjesëmarrës në plotësimin e pyetësorit, por vlerësimin e studentëve për çdo lëndë inësimore (një student vlerëson të gjitha lëndët ku ai ka marrë pjesë gjatë semestrit të parë dhe të dytë të vitit akademik 2017-2018).

Kufizimet e Vlerësimit

Duke qenë i part raport për vlerësimin dhe matjen e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në nivel institucioni i ndërmarrë prej Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL

Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional dhe Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë u hasën një sërë kufizimesh teknike dhe metodologjike si:

- Organizimi i pyetësorit vetëm në ciklin e parë të studimeve duke mos përfshirë studentët që ndjekin ciklin e dytë.
- Pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorëve gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2017-2018.
- Të dhënat e pyetësorëve si dhe paraqitja grafike e tyre u përpunua manualisht dhe jo prej sistemit elektronik duke sjellë shumë vonesë në hartimin e raportit.

Me qëllim shmangijen e këtyre kufizimeve sugjerojmë:

- Përgatitja e platformës në UVMS për hedhjen e pyetësorit me qëllim plotësimin e tij prej studentëve të ciklit të dytë të studimit.
- Përmirësimi i Sistemit UVMS me qëllim gjenerimin e të dhënave të përpunuara drejt-përdrejtë nga sistemi, të tilla si grafikë, tabela statistikore etj.
- Organizimin e një fushate sensibilizuese çdo fillim viti akademik me qëllim ngritjen e kulturës së përfshirjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e përfshirjes në vlerësimin e programit të studimit. Kjo fushatë të organizohet prej NJSBC në bashkëpunim me Njësitë Kryesore/ Baze si dhe Këshillin Studentor.

Konkluzione:

- Nga të dhënat e dala nga përpunimi i pyetësorëve të studentëve, veçojmë si pika të dobëta në shumë prej programeve mësimore *infrastrukturën* e auditoreve si dhe *mungesën e laboratoreve didaktik* në disa prej lëndëve, të cilat e kanë domosdoshmëri orën laboratorike.
- Pothuaj në të gjithë programet mësimore studentët shpreheshin se mësimi ishte i mërzitshëm, aspak interesant dhe me një nivel vështirësie shumë të lart.
- Një tjetër kritikë e studentëve ishte dhe mos inkurajimi i diskutimit në klasë apo i mendimit kritik prej pedagogëve të caktuar.
- Për shumë studentë frekuentimi i leksioneve ishte i panevojshëm pasi sipas tyre nuk mund të përfitoje asnjë njohuri më tepër nga çfarë ishin të përfshira në tekste.
- Në pjesën më të madhe të përgjigjeve në dy pyetjeve të hapura studentët i vinin theksin organizmit të praktikave mësimore si një domosdoshmëri për të përvetësuar njohuritë e fituara gjatë viteve të studimit.

Bashkëlidhur: Shtojca nr. 1 - Fakulteti i Shëndetit Publik

Shtojca nr. 2 - Fakulteti i Ekonomisë

Slitjca nr. 3- Fakulteti i Shkencave Humane

Shtojca nr. 4- Fakulteti i Shkencave Teknike

Faqe 4 nga 4